



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 37/2023

në lidhje me themelimin e organeve të kujdestarisë

Drejtuar:

- Z. Bashkim Ramosaj, kryetar, Komuna e Deçanit
- Z. Bexhet Xheladini, kryetar, Komuna e Dragashit
- Z. Ramiz Lladrovci, kryetar, Komuna e Gllogocit
- Z. Burim Berisha, kryetar, Komuna e Fushë Kosovës
- Z. Agim Aliu, kryetar, Komuna e Ferizajt
- Z. Ardian Gjini, kryetra, Komuna e Gjakovës
- Z. Alban Hyseni, kryetar, Komuna e Gjilanit
- Znj. Ljiljana Šubarić, kryetare, Komuna e Graçanicës
- Z. Mehmet Ballazhi, kryetar, Komuna e Hanit të Elezit
- Z. Ilir Ferati, kryetar, Komuna e Istogut
- Z. Ruzhdi Shehu, kryetar, Komuna e Junikut
- Z. Besim Ilazi, kryetar, Komuna e Kaçanikut
- Z. Kadri Rahimaj, kryetar, Komuna e Kamenicës
- Z. Zenun Elezaj, kryetar, Komuna e Klinës
- Z. Vladan Bogdanović, kryetar, Komuna e Kllkotit
- Z. Imri Ahmeti, kryetar, Komuna e Lipjanit
- Z. Abdülhadî Krasniç, kryetar, Komuna e Mamushës
- Z. Bedri Hamza, kryetar, Komuna e Mitrovicës së Jugut
- Z. Saša Milošević, kryetar, Komuna e Novobërdës
- Z. Xhafer Gashi, kryetar, Komuna e Obiliqit

- Z. Dragan Petković, kryetar, Komuna e Parteshit
- Z. Shpejtim Bulliqi, kryetar, Komuna e Podujevës
- Z. Përparim Rama, kryetar, Komuna e Prishtinës
- Z. Shaqir Totaj, kryetar, Komuna e Prizrenit
- Znj. Katarina Ristić-Ilić, kryetare, Komuna e Ranillugut
- Z. Dalibor Jevtić, kryetar, Komuna e Shtërpcës
- Z. Fadil Nura, kryetar, Komuna e Skenderajt
- Z. Sokol Haliti, kryetar, Komuna e Vitisë
- Z. Ferit Idrizi, kryetar, Komuna e Vushtrrisë

Kopje:

- Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 12 tetor 2023

Qëllimi i raportit

Ky raport ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së autoriteteve publike dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për trajtimin dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësisive ligjore lidhur me krijimin dhe funksionalizimin e Organit të Kujdestarisë për realizimin e detyrave që kërkohen sipas legjislacionit përkatës në Republikën e Kosovës.

Kompetencat e Avokatit të Popullit

1. Në përputhje me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta): *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* Kushtetuta më tutje në nenin 135, paragrafi 3, parasheh: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);*
 - *të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 16, paragrafi 4);*
 - *Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastiit kur ka zvarritje të procedurave (neni 16, paragrafi 8);*
 - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, par. 1, nënparagrafi. 1.2);*
 - *t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”* (neni 18, par. 1, nënparagrafi. 6).

Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

3. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4¹, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 27 janar 2023 ka hapur rast ex officio lidhur me çështjen e formimit dhe funksionalizimit të Organit të Kujdestarisë, në pajtim me Ligjin nr.02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare.
4. Gjatë muajit mars 2023, Avokati i Popullit ka kërkuar informata nga komunat e Kosovës² në disa pyetje konkrete, në mënyrë që t'i merrte informatat e duhura dhe të shihte pasqyrën e qartë lidhur me rastin:
 - *“Komuna që udhëhiqni ju, a e ka themeluar Organin e Kujdestarisë? Nëse po, na e dërgoni kopjen e aktit të themelimit.*
 - *Nëse komuna që udhëhiqni ju e ka të themeluar Organin e Kujdestarisë, na tregoni se kush e përbën atë?*
 - *Na e ofroni çdo informatë apo dokument tjetër relevant, që konsideroni se mund t'i ndihmojë dhe plotësojë të dhënat për çështjen në fjalë.”*
5. Gjatë muajve mars dhe prill 2023, Institucioni i Avokatit të Popullit, për informatat e kërkuara lidhur me çështjen, ka marrë përgjigje nga këto komuna: Mitrovicë e Jugut, Mamushë, Malishevë, Lipjan, Istog, Gllogoc, Gjakovë, Dragash, Ferizaj, Kamenicë, Kaçanik, Vushtrri, Shtime, Rahovec, Obiliq, Shtërpçë, Novobërdë dhe Partesh.
6. Meqenëse jo të gjitha komunat janë përgjigjur në kërkesën e Avokatit të Popullit për informata lidhur me çështjen, në qershor të vitit 2023 Avokati i Popullit u ka dërguar letër përsëritëse komunave që nuk janë përgjigjur³, duke ua rikujtuar nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës⁴, dhe nenet 18 dhe 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit, që u bëjnë thirrje autoriteteve publike t'u përgjigjen kërkesave të Institucionit të Avokatit të Popullit për sigurimin e informacioneve, dokumenteve dhe dosjeve brenda kohës së arsyeshme.
7. Gjatë muajit qershor 2023, Institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë përgjigje nga këto komuna: Junik⁵, Graçanicë, Klllokot, Prishtinë, Klinë, Hani i Elezit⁶, Suharekë, Pejë, Gjilan, dhe Ranillug.⁷

¹Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex-officio), nëse nga konstatimet, nga dëshmitë dhe nga faktet e paraqitura me parashtrësë, ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut, të përcaktuara me Kushtetutë, me ligje dhe me akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

² Komunat: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Mamushë, Malishevë, Lipjan, Klinë, Istog, Gllogoc, Gjakovë, Junik, Dragash, Deçan, Ferizaj, Skenderaj, Pejë, Kamenicë, Kaçanik, Hani i Elezit, Gjilan, Vushtrri, Viti, Suharekë, Shtime, Rahovec, Prizren, Obiliq, Shtërpçë, Novobërdë, Ranillug, Partesh, Klllokot dhe Graçanicë.

³ Komunat: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Klinë, Junik, Deçan, Skenderaj, Pejë, Hani i Elezit, Gjilan, Viti, Suharekë, Prizren, Ranillug, Klllokot dhe Graçanicë, për informatat e kërkuara lidhur me çështjen.

⁴ Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

⁵ Komuna e Junikut bashkëngjiti dëshminë e parashtrësës njoftuese dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 6 prill 2023.

8. Avokati i Popullit, deri në publikimin e këtij raporti, nuk pranoi përgjigje nga komunat: Podujevë, Fushë Kosovë, Deçan, Skenderaj, Viti dhe Prizren. Në këtë rast këto komuna kanë dështuar të përgjigjeshin në kërkesat e Avokatit të Popullit duke shkelur dispozitat përkatëse kushtetuese dhe Ligjin për Avokatin e Popullit. Sidoqoftë, kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit t'i japë konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me çështjen.⁸

Instrumentet relevante ligjore dhe analiza e çështjes

9. Legjislacioni në Republikën e Kosovës përfshin një numër të madh aktesh normative-juridike, të cilat synojnë të sigurojnë mbrojtjen e veçantë për fëmijë. Fillimisht Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke përfshirë këtu edhe të drejtat e fëmijës. Zbatimi dhe realizimi në praktikë i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Kushtetuta shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha institucioneve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut⁹, dhe ky parim vlen për të gjithë, përfshirë edhe institucionet përkatëse komunale, duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore në formimin dhe funksionalizimin e Organit të Kujdestarisë, si mekanizëm profesional kompetent dhe përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijës në rrethanat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Për më tepër, Kushtetuta në nenin 50 përcakton obligimet e të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës për t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e jetës së fëmijës, mirëqenien, mbrojtjen nga abuzimet, nga keqpërdorimet, si dhe mbrojtje të tjera në të gjitha fushat e jetës, që janë në interes të mirëqenies së tij/saj.
10. Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës¹⁰, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës¹¹ (në tekstin e mëtejme për të dy ligjet: Ligji për familjen), rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësimin), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare. Ky ligj në nenin 6 (Mbrojtja institucionale e të drejtave) ka përcaktuar: *“(1) Punët e mbrojtjes dhe të ndihmës familjare do t'i ushtron organi kompetent i administratës komunale i cili është kompetent për punët e mbrojtjes sociale. (2) Organi i Kujdestarisë është një organ komunal administrativ kompetent për çështje sociale. Ai përbëhet nga një grup i ekspertëve me përvojë profesionale në fushën e veçantë të përgjegjësisë. (3) Organi i Kujdestarisë mundet gjithashtu të jetë organ (grup i ekspertëve siç është cekur*

⁶ Komuna e Hanit të Elezit bashkëngjiti dëshminë e parashtresës njoftuese dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 3 prill 2023.

⁷ Komuna e Ranillugës bashkëngjiti dëshminë e parashtresës njoftuese dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 5 prill 2023.

⁸ Ligji për Avokatin e Popullit, neni 24, paragrafi 4: *“Refuzimi apo dështimi për t'iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës së Avokatit të Popullit. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit për të nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet e tij.”*

⁹ Kushtetuta, neni 21: *“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. 2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. 3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. 4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*

¹⁰ Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë/Prishtinë: Viti I / nr. 4/01 shtator 2006.

¹¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 3/17 janar 2019, Prishtinë.

më lart) i veçantë i institucionit social i themeluar nga Kuvendi Komunal për të kryer detyrat e tilla. (4) Organi i Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë është i autorizuar të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, të paraqes fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrojë mjetet juridike dhe të ndërmer veprime tjera gjyqësore. Gjykata është e obliguar të ftojë në gjyq Organin e Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t'i dorëzojë atij të gjitha vendimet.” Në dritën e këtyre normave ligjore vërehet se kompetenca dhe përgjegjësia e Organit të Kujdestarisë i përmendur mbi 195 herë në dispozita përkatëse të Ligjit për Familjen, tregon rëndësinë dhe peshën që ka ky mekanizëm në mbrojtjen e fëmijës, përkatësisht për mbrojtjen e interesave të tyre në rrethanat dhe kushtet e përcaktuara me ligj. Për më tepër, sipas Komentarit të Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës¹², është saktësuar se punët e shërbimeve sociale për çështje familjare i kryen Organi i Kujdestarisë, i specializuar dhe i përbërë nga ekspertët e kësaj fushe, respektivisht i punëve sociale dhe familjare. Funkzionimi dhe organizimi i brendshëm i këtij organi është rregulluar me ligj të veçantë.¹³ Secila komunë formon qendrën për punë sociale, në përbërjen e së cilës veprojnë ekspertë të specializuar për punë sociale. Gjithashtu, brenda qendrës për punë sociale formohet Organi i Kujdestarisë, si organ i specializuar, që kryen detyra të specializuara që kërkohen me ligje të caktuara, duke përfshirë edhe detyrat që i ngarkohen sipas Ligjit për Familjen.¹⁴

11. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Organit të Kujdestarisë, si mekanizëm shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, janë të përcaktuara edhe në disa ligje të tjera duke përfshirë edhe aktet nënligjore, por pa u kufizuar në Ligjin nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare; në Ligjin nr. 04/I-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare; në Ligjin nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, në Kodin Nr.06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur; në Udhëzimin Administrativ (QRK) -nr. 02/2021 për Zbatimin e Drejtësisë Mike ndaj Fëmijës në Procedurën Penale, Civile dhe Administrative; në Udhëzimin Administrativ (QRK)-nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale.
12. Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare¹⁵ (në tekstin e mëtejshëm: Ligji bazë për shërbime sociale dhe familjare), i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare¹⁶ (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i ndryshuar për shërbime sociale dhe familjare), pos të tjerash, rregullojnë: “[...] ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë. Në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjislacionin e Kosovës dhe në

¹² <http://jus.igjk.rks-gov.net/513/1/KOMENTAR-Ligji%20per%20familjen%20i%20Kosoves.pdf>

¹³ Bëhet referencë në Ligjin për shërbime sociale dhe familjare.

¹⁴ Komentari i Ligjit për Familjen i Kosovës, (Prishtinë, Shtator 2012) fq. 37

¹⁵ Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë/Prishtinë: viti II/Nr. 12/01 maj 2007.

¹⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 5/05 prill 2012, Prishtinë.

konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut [...].” Ligji i ndryshuar për shërbime sociale dhe familjare, në nenin 1, paragrafi 6, ka përcaktuar: “*Qendra për Punë Sociale (QPS)- është institucion publik profesional i nivelit komunal, kompetente për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale.*” Sipas Ligjit bazë për shërbime sociale dhe familjare, secila komunë themelon një qendër për punë sociale, që do të ketë një apo më shumë degë dhe personel të përbërë nga profesionistë me trajnime dhe kualifikime përkatëse.¹⁷

13. Në dhjetor të vitit 2019, Avokati i Popullit kishte publikuar raportin me rekomandime ex-officio, me të cilin kishte vlerësuar nëse ofrimi i shërbimeve sociale në Republikën e Kosovës është në pajtim me standardet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kishte dhënë rekomandimet specifike në drejtim të përmirësimit të gjendjes aktuale.¹⁸ Raporti kishte gjetur, pos të tjerash, se qendrat për punë sociale (në tekstin e mëtejshëm: QPS) ofrojnë mbi 50 lloje të shërbimeve sociale dhe zyrtarët e shërbimeve sociale nuk i kanë të ndara referatet, por janë të obliguar të merren me të gjitha kategoritë e rasteve dhe të shërbimeve sociale profesionale. Tutje raporti kishte vlerësuar se është e domosdoshme që stafi i QPS-ve të profilizohet, pasi natyra e punës për lëndët e caktuara është diametralisht e kundërt dhe një zyrtar i shërbimeve sociale nuk ka kapacitet t’i kryejë në të njëjtën kohë të gjitha shërbimet me profesionalizëm të njëjtë. Gjithashtu numri i tyre është i pamjaftueshëm për t’i kryer detyrat e QPS-ve, të parapara me ligj. Në veçanti, për sa u përket fëmijëve, shumica e QPS-ve nuk janë në gjendje ta përmbushin obligimin ligjor rreth Organit të Kujdestarisë. Asnjë QPS nuk ka psikolog të licencuar, i cili mund ta jepte mendimin profesional për besimin e fëmijëve për çështjet e adoptimit si dhe për fusha të tjera. Raporti konstaton se QPS-të janë shndërruar në institucione administrativo-teknike, për shkak të mungesës së stafit profesional dhe mungesës së objekteve përcjellëse për ofrim të shërbimeve adekuate. Ka mungesë të mbikëqyrjes, të planifikimit, të financimit dhe të avancimit të shërbimeve në përputhje me nevojat e komunave. Avokati i Popullit u kishte rekomanduar autoriteteve përgjegjëse t’i adresonin problemet e identifikuar, në mesin e këtyre rekomandimeve kishte qenë edhe themelimi dhe funksionalizimi i qendrave për punë sociale në komunën e Junikut, të Parteshit, të Mamushës, të Klllokotit dhe të Graçanicës.
14. Ligji i ndryshuar për shërbime sociale dhe familjare, në nenin 1, paragrafi 7, ka përcaktuar: “*Organi i Kujdestarisë-është organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale.*” Ligji bazë për shërbime sociale dhe familjare, në nenin 7, paragrafi 7.2, ka përcaktuar: “*Qendra për punë sociale formon organin e kujdestarisë dhe kryen detyrat që kërkohen për këtë funksion siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Kosovës.*” Me këtë dispozitë ligjore, ligjdhënësi i ka dhënë kompetencë funksionale QPS-ve që ta formojnë Organin e Kujdestarisë, në mënyrë që ky organ profesional t’i kryejë detyrat që kërkohet me legjislacioni përkatës në fuqi.¹⁹ Rrjedhimisht, për ta përmbushur këtë obligim ligjor në

¹⁷ Ligjit bazik për shërbime sociale dhe familjare, neni 7 paragrafi 7.1, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin e ndryshuar për shërbime sociale dhe familjare, nenin 7 paragrafi 1.

¹⁸ Institucioni i Avokatit të Popullit: Ex officio nr. 59/2019 lidhur me vlerësimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale në Kosovë, Prishtinë, 17 dhjetor 2019.

¹⁹ Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligji nr. 06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës; Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe

formimin e Organit të Kujdestarisë, komunat duhet të sigurojnë që QPS-të në territorin e tyre kanë resurse njerëzore, përkatësisht numrin e personelit profesional që duhet punësuar, varësisht prej shërbimeve që kërkohet sipas ligjit.²⁰

15. Për më tepër, Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm: LMF)²¹, në nenin 1 ka përcaktuar qëllimin e tij: “[...] 1.2. të mbrojtë fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës; 1.3. të garantojë dhe sigurojë përgjegjësitë e prindërve, familjes, **organit të kujdestarisë, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin më të mirë të fëmijës; [...]**.” LMF-ja është ligji i parë në Kosovë që në mënyrë specifike adreson mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duke përfshirë edhe garancinë për sigurimin e përgjegjësive të Organit të Kujdestarisë, si organ përgjegjës që vepron në kuadër të qendrës për punë sociale - përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës.²²
16. Po ashtu, LMF-ja në nenin 27 (Ndarja e fëmijës nga familja) ka përcaktuar: “1. Fëmija nuk do të largohet nga kujdesi i prindit/prindërve të tij ose të kujdestarit të tij ligjor pa lejen e tyre apo pa urdhër të gjykatës. 2. Përjashtimisht, kur organi i kujdestarisë ka arsye të bazuar për të besuar se ekziston rrezik serioz i drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës, organi i kujdestarisë mund të hyjë në cilindo vend dhe të largojë fëmijën në një vend të sigurt, ku ai/ajo do të ketë përkujdesje për një periudhë që nuk kalon shtatëdhjetë e dy (72) orë. 3. Para se të skadojë afati prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve, organi i kujdestarisë rastin duhet ta paraqesë në gjykatën kompetente, e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës. Nëse e kërkojnë rrethanat, gjykata mund të jep urdhër për vlerësim për një periudhë njëzet e një (21) ditëshe, për të mundësuar hetime të mëtutjeshme dhe vlerësime deri në kohë kur çështja duhet të paraqitet në gjykatë për shqyrtim të mëtejshëm. 4. Fëmija nuk mund të ndahet nga prindërit, kujdestari i tij kundër dëshirës dhe vullnetit të tij, përveç se në rastet nëse kjo ndarje është në interesin më të mirë të fëmijës, nëse fëmija është në rrezik dhe nëse kjo ndarje është e pashmangshme dhe nëse kjo ndarje kërkohet nga ligji ose nga një vendim i gjykatës i formës së prerë. Nëse fëmija ndahet nga prindërit, kujdestari i tij, pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës duhet të dëgjohen, konsiderohen dhe dokumentohen në dokumentacionin që hartohet për këtë qëllim. Pikëpamjet e fëmijës duhet të dëgjohen dhe dokumentohen nga shërbimet sociale ose gjykata. [...]”
17. Për më tepër, Udhëzimi Administrativ (QRK) -nr. 02/2021 për Zbatimin e Drejtësisë Mike ndaj Fëmijës në Procedurën Penale, Civile dhe Administrative, në nenin 20

Familjare; Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare; Ligji nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Kodi Nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur; Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore; Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore; Udhëzim Administrativ (QRK) - nr. 02/2021 për Zbatimin e Drejtësisë Mike ndaj Fëmijës në Procedurën Penale, Civile dhe Administrative, Udhëzimi Administrativ (QRK)-nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale etj.

²⁰ Ligji bazë për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 6, paragrafi 6.6.

²¹Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.14/17, korrik 2019, Prishtinë gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844.

²² LMF-ja, neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.45: “*Organi i kujdestarisë - nënkupton organin përgjegjës që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës.*”

parasheh si masë për sigurinë e fëmijës, ofrimin e mbrojtjes fëmijës viktimë dhe dëshmitarë nga policia ose nga Organi i Kujdestarisë, në partneritet me subjektet e tjera publike dhe private, që ofrojnë mbrojtje dhe strehim, në rastet kur fëmija mund të jetë objekt kanosjeje, kërcënimi ose dëmtimi.²³ Edhe Udhëzimi Administrativ (QRK) - nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale ka paraparë angazhimin e Organit të Kujdestarisë në shumë procese kyçe për mbrojtjen e fëmijës që nga programi i mbrojtjes, ndihma juridike dhe përgjatë trajtimit të rastit. Këto përgjegjësi janë të shpërndara në dispozitat përkatëse, si: neni 4 - Mosfillimi i procedurës gjyqësore; neni 17 - Vlerësimi gjithëpërfshirës profesional për mbrojtje dhe trajtim të fëmijës; neni 18 - Kërkesa në gjykatë për një urdhër vlerësim gjithëpërfshirës për mbrojtje dhe trajtim të fëmijës; neni 20 - Vendosja e fëmijës jashtë shtëpisë; neni 21 - Vendosja e fëmijës në format e mbrojtjes së përkohshme; neni 23 - Mbrojtja e fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale nga Organi i Kujdestarisë; neni 24 - Mbrojtja e fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale në situata urgjente; neni 31 - Programi i Mbrojtjes së Fëmijës; dhe neni 51 - Mbikëqyrja e ofrimit të shërbimeve sociale.²⁴

18. Më 3 prill 2023, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me rekomandime ex-officio nr. 468/2022 lidhur me detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna.²⁵ Rasti është hapur sipas detyrës zyrtare për të tërhequr vëmendjen e institucioneve publike lidhur me detyrimet pozitive të shtetit përkitazi me mbrojtjen e fëmijës nga dhuna. Gjithashtu, ky raport vlerëson se sa kanë qenë efektive, të arsyeshme dhe të shpejta veprimet e ndërmarra nga institucionet kompetente shtetërore me qëllim të mbrojtjes së fëmijës nga dhuna, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet si dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare. Në rastin konkret, Avokati i Popullit ka vlerësuar se Organi i Kujdestarisë nuk është marrë fare me çështjen, si organ komunal profesional për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve. Në këtë drejtim i ka rekomanduar Komunës së Prishtinës: *“T’i rrisë kapacitetet profesionale të Organit të Kujdestarisë për ta ushtruar mandatin e plotë sipas ligjit, në rastet kur fëmijët janë viktimë të dhunës. T’i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale dhe të përgatisë module obliguese, të veçanta trajnimi për ta, veçmas sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, Pjesa e Pestë (Mbrojtja e fëmijëve viktimë të veprave penale).”* Po ashtu, edhe në Raportin me rekomandime ex-officio nr.567/2019 në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në rastin e K. V.²⁶, Avokati i Popullit ka vlerësuar se Organi i Kujdestarisë nuk është marrë fare me çështjen, si organ komunal profesional për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve.

²³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=36550>

²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=36551>

²⁵ <http://oik-rks.org/2023/04/03/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-4682022-detyrimet-pozitive-te-shtetit-per-mbrojtjen-e-femijes-nga-dhuna/>

²⁶ <http://oik-rks.org/2019/12/09/raporti-me-rekomandime-ex-officio-567-2019-ne-lidhje-me-detyrimet-pozitive-te-shtetit-te-garantuara-me-ushtetuten-e-republikes-se-kosoves-si-dhe-me-nenin-2-te-konventes-evropjane-per-mbrojtjen-e-te-d/>

19. Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur²⁷ rregullon veprimin ndaj të miturit, si kryerës i veprës penale, ndaj fëmijëve e përfshirë dhe të miturve si pjesëmarrës në procedurë, ndaj organeve të cilat zbatojnë procedurën penale dhe ekzekutimin e masave dhe dënimeve ndaj kryerësit të mitur të veprës penale, si dhe mbrojtjen e personave të mitur dhe fëmijëve të cilët janë viktimë dhe të dëmtuar nga vepra penale. Ky kod e përkufizon Organin e Kujdestarisë si organ përgjegjës që vepron në kuadër të qendrës për punë sociale, i cili është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve.²⁸ Duke parë rëndësinë që ka ky mekanizëm në mbrojtjen e fëmijëve në kuadër të fushëveprimit të këtij kodi, ligjdhënësi i ka caktuar detyra në shumë dispozita të këtij kodi, si: Neni 3 - Përkufizimet; neni 7 - Përcaktimi i masave mbrojtëse; Neni 8 - Procedura e mbrojtjes së fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale; Neni 23 - Llojet dhe kohëzgjatja e masave edukative; Neni 27 - Mbikëqyrja e shtuar nga Organi i Kujdestarisë; Neni 36 - Lirimi me kusht nga burgimi për të mitur; Neni 38 - Qëllimi dhe shqiptimi i masave të trajtimit të detyrueshëm; Neni 45 - Njoftimi për fillimin dhe rrjedhën e procedurës; Neni 52 - Fillimi i procedurës përgatitore; Neni 55 - Garantimi i të drejtave procedurale; Neni 56 - Pushimi i procedurës përgatitore; Neni 65 - Personat e pranishëm në shqyrtimin gjyqësor; Neni 66 - Përrjashtimi i publikut; Neni 75 - Parimet e përgjithshme mbi ekzekutimin e masave edukative jointucionale; Neni 78 - Masat adekuate të mbrojtjes; Neni 81 - Ekzekutimi i masës së mbikëqyrjes së shtuar nga Organi i Kujdestarisë; Neni 97 - Ekzekutimi i urdhrin për punë në dobi të përgjithshme; Neni 106 - Ndihma gjatë dhe pas lirit; Neni 112 - Veprimet procedurale; dhe Neni 113 - Heqja e të drejtave për përkujdesje prindërore.

Konstatimet

20. Pas rishikimit të legjislacionit përkatës, të instrumenteve ndërkombëtare, të dokumentacionit të çështjes, të informatave dhe të të dhënave që Institucioni i Avokatit të Popullit i ka në dispozicion, del se në rastin konkret ka shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, përkatësisht të të drejtave të fëmijëve, pasi autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore e as standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës, në lidhje me formimin dhe funksionalizimin e Organit të Kujdestarisë, sipas ligjit.
21. Avokati i Popullit, në bazë të dokumentacionit që ka pranuar nga komunat, përkatësisht vendimet për themelimin e Organit të Kujdestarisë, vëren se pesë komuna e kanë themeluar Organin e Kujdestarisë.
22. Avokati i Popullit, në bazë të autorizimeve ligjore, dokumentacionit të pranuar si dhe mosfrimit të dëshmimeve, përkatësisht të vendimit për themelimin e Organit të Kujdestarisë²⁹, konstaton se komunat: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Mamushë, Lipjan, Klinë, Istog, Gllogoc, Gjakovë, Junik, Dragash, Deçan, Ferizaj, Skenderaj, Kamenicë, Kaçanik, Hani i Elezit, Gjilan, Vushtrri, Viti, Prizren, Obiliq, Shtërpçë, Novobërdë, Ranillug, Partesh, Klllokot dhe Graçanicë nuk kanë themeluar organ

²⁷ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 17/18 tetor 2018, Prishtinë

²⁸ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10: "Organ i kujdestarisë – organi përgjegjës që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale i cili është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve;"

²⁹ Gjatë muajit mars 2023, Avokati i Popullit, ka kërkuar informata në disa pyetje konkrete, në mënyrë që t'i marrte informatat e duhura dhe të shihej pasqyra e qartë lidhur me rastin: *Komuna që udhëhiqni ju, a e ka themeluar organin e kujdestarisë? Nëse po, na e dërgoni kopjen e aktit të themelimit.*

të kujdestarisë, siç kërkohet me nenin 7 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare. Rrjedhimisht, mosthemelimi i këtij organi pamundëson zbatimin e dispozitave të Ligjit nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, të Kodit Nr.06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur; të Udhëzimit Administrativ (QRK) -nr. 02/2021 për Zbatimin e Drejtësisë Mike ndaj Fëmijës në Procedurën Penale, Civile dhe Administrative dhe të Udhëzimit Administrativ (QRK)-nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale.

23. Avokati i Popullit, pas vlerësimit të përgjigjes nga Komuna e Parteshit³⁰, lidhur me kërkesën e Institucionit të Avokatit të Popullit për informata rreth formimit të Organit të Kujdestarisë, vëren se Komuna e Parteshit ende nuk e ka themeluar Organin e Kujdestarisë, sepse ende nuk e ka themeluar qendrën për punë sociale.
24. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla [...].”*

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Komunës së Deçanit

- T’i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T’i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t’i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Dragashit

- T’i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T’i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t’i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Gllgocit

- T’i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.

³⁰ Shkresa e Komunës së Parteshit, e protokolluar në Institucionin e Avokatit të Popullit: 195/2023, DT.12.04.2023.

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Fushë Kosovës

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Ferizajt

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Gjakovës

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Gjilanit

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Graçanicës

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Hanit të Elezit

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Istogut

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Junikut

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Kaçanikut

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Kamenicës

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Klinës

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Kllokotit

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Lipjanit

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Mamushës

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Mitrovicës së Jugut

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Novobërdës

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Obiliqit

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Parteshit

- Ta themelojë dhe funksionalizojë Qendrën për Punë Sociale, sipas nenit 7 të Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare.
- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Podujevës

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Prishtinës

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Prizrenit

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Ranillugut

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Shtërpçës

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të organit të kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Skenderajt

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Vitisë

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komunës së Vushtrrisë

- T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale, për zbatimin e plotë të ushtrimit të mandatit të Organit të Kujdestarisë.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që Qendra për Punë Sociale, në pajtim me nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta formojë Organin e Kujdestarisë dhe t'i kryejë detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka

drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

